



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1057/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore, Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me apelin e Farije Bytyqi, kandidatë për anëtare për Kuvendin Komunal në Prizren, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Prizren paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar apeli i Farije Bytyqi, kandidatë për anëtare për Kuvendin Komunal në Prizren, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Prizren, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Prizren, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Prizren në Vendvotimet nr.2005A/09D,2042A/07R, 2006A/01R, 2006A/04R

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin më datë 13.11.2017, i cili është dërguar përmes dërgesës së postës më datë 10.11.2017 nga Faredin Hoti, kandidatë për anëtar të Kuvendit Komunal, Prizren, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Prizren me të cilën ka pretenduar se ka mospërputhje të votave me rezultatet e publikuara nga KQZ në vendvotimet 2005A/09D, 2042A/07R,2006A/01R dhe në vendvotimin 2006A/04R. Parashtruesi i apelit pretendon se në vendvotimin 2005A/09D i mungojnë 9 vota në vv.2042A/07R i mungojnë 6 vota, në vv.2006A/01R i mungojnë 36

vota dhe në vv.2006A/04R i mungojnë 28 vota. Kërkon nga PZAP-i të bëhet rinumërimi i këtyre vendvotimeve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së pretendimeve në apel si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në vendvotimet si në pjesën e II të dispozitivit të vendimit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura paneli e miratoi apelin e apeluesit si të bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze. Nga sa u tha më sipër e duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.A.nr.1057/2017 me datë 13.11.2017

Kryesuese e Panelit

Rafet Haxhaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.